



K.B.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL**

Nr. 7832 prot.

Vlorë, më 23.04, 2026

PROJEKTVENDIM

Nr. _____ datë _____ 2026

PËR

**NGRITJEN E QENDRAVE KOMUNITARE SOCIAL KULTURORE PËR
MOSHAT E TRETA NË NJËSITË ADMINISTRATIVE TË BASHKISË VLORË**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore"; Ligjit nr.121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 23.2.2018; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.823, datë 06.12.2006, për "Standartet e shërbimeve për të moshuarit në qendrat ditore"; Ligjit nr.68/2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 45; Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 44 ; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9 date 20.03.2018, VKB nr.100 datë 23.12.2025, "Mbi miratimin e buxhetit për vitin 2026" si dhe në relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë, Këshilli Bashkisë në mbledhjen e datës 04.2026:

VENDOSI:

1. Miratimin e ngritjes të qendrave komunitare social kulturore për moshat e treta në Njësitë Administrative të Bashkisë Vlorë.
2. Stafi i qendrave ditore të të moshuarve do të jenë punonjësit aktualë të strukturave të Njësive Administrative.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social; Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të nenit 55/6 të të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL**

Nr. 4832 prot.

Vlorë, më 23.04 2026

RELACION

mbi

PROJEKTVENDIMIN

**“NGRITJEN E QENDRAVE KOMUNITARE SOCIAL KULTURORE PËR
MOSHAT E TRETA NË NJËSITË ADMINISTRATIVE TË BASHKISË
VLORË”.**

Bashkia Vlorë në kuadër të nevojës për të zgjeruar shërbimet me bazë komunitare dhe ato psiko sociale dhe kulturore po realizon objektivin strategjik 2 nga objektivat specifik të Planit Social Lokal 2025-2027. Specifikisht objektivi strategjik 2 përmban : “Ngritjen dhe përmirësimin e njetit të shërbimeve dhe kujdesit shoqëror komunitar, duke përfshirë zgjerimin dhe funksionin efektiv të shërbimeve ekzistuese, si dhe krijimin e shërbimeve të reja, për të siguruar mbulimin e plotë dhe të qëndrueshem të nevojave sociale të komunitetit”. Qendra komunitare për të moshuarit është një strukture sociale dhe kulturore, e cila ofron shërbime ditore , aktivitete sociale dhe mbështetje psikosociale për personat e moshës së tretë me qëllim përmirësimin e mirëqënies dhe përfshirjes së tyre në jetën komunitare. Qëllimi i krijimit të qendrave është:

1. Reduktimi i izolimit social të të moshuarve.
2. Promovimi i një jete aktive dhe të shëndetëshme.
3. Rritja e përfshirjes së tyre në jetën komunitare.

Aktiviteti i Qendrave komunitare për të moshuarit kanë këto objektiva:

Objektivi 1: Fuqizimi social nëpërmjet nxitjes, ndërveprimit dhe socializimit mes të moshuarve .

Objektivi 2.: Parandalimi i izolimit dhe përjashtimit social.

Objektivi 3: Mirëqenia dhe shëndeti nëpërmjete promovimit të aktiviteteve fizike dhe informuese mbi shëndetin.

Objektivi 4: Përfshirja aktive nëpërmjet aktivizimit të të moshuarve në jetën sociale dhe kulturore. Nxitja dhe bashkpunimi ndërbrezor.

Objektivi 5: Mbështetja socioale nëpërmjete këshillimit social dhe psikologjik, informimi mbi të drejtat dhe shërbimet sociale, promovimi i aftësive dhe eksperiencës të të moshuarve.

Objektivi 6: Qëndrueshmëria në kohë e Qendrës Ditore komunitare.

Numri i të moshuarve si përfitues :

- Njësia administrative Qender: Rreth 600 të moshuar përfitues të shërbimeve
- Njësia administrative Orikum: Rreth 650 të moshuar përfitues të shërbimeve.
- Njësia administrative Novolelë: Rreth 800 të moshuar përfitues të shërbimeve.
- Njësia administrative Shushicë: Rreth 550 të moshuar përfitues të shërbimeve.

Konceptoi: *K.Billa*



Drejtor i Ndhmës dhe Shërbimit Social

Irena Stasa

